

Shoqëria: KIDA. Shpk

NIPT: K82731805K

Selia: Rrogozhinë

VENDIM I ORTAKUT TË VETËM

Në datën 14.10.2025 ortaku I vetëm i shoqërisë "KIDA." Shpk, me NIPT K82731805K, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar pranë QKB-së me datë 31.03.2008 zhvilloi mbledhjen në selinë e shoqërisë: Njësia Administrative Lekaj, Autostrada Kavajë-Rrogozhinë, Zonë Kadastrale 1932, Pasuria Nr. 193/15, Nd. 84, Bashkia Rrogozhinë, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe aktin e themelimit/statutin e shoqërisë.

I pranishëm në këtë mbledhje është:

Dragush Leçini zotërues i 1 kuote që përfaqëson 100% të kuotave të kapitalit me vlerë 37.000.000 lekë

Rendi I ditës:

Zmadhimi I kapitalit të shoqërisë nga fitimet e pashpërndara në vlerën prej 31.000.000 lekë.

Pas shqyrtimit të pikës së rendit të ditës, mbështetur në Statutin e shoqërisë, ligjin 10091 datë 05.03.2009 "Për Auditimin ligjor, organizimin e profesionit", ligjin 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare", në respektim të ligjit 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat Tatimore në RSH" si dhe ligjit 9723 datë 10.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar, ortaku I vetëm

VENDOSI

Të zmadhohet kapitali i shoqërisë nga fitimet e pashpërndara në vlerën prej 31.000.000 lekë

Pas zmadhimit të kapitalit ortaku i saj zotëron si më poshtë:

Dragush Leçini zotërues i 1 kuote që përfaqëson 100% të kuotave të kapitalit me vlerë 68.000.000 lekë

Ortaku i vetëm

Dragush Leçini

